



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Gouvernement

Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera- The Prime Minister Office

Në bazë të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik, neni 39 (1,2,3, 4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit shpallë:

Konkurs

Pranim

[Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar:](#)

Emri i grupit:	Specialist Ligjor
Titulli i pozitës së punës :	Zyrtar i lartë Ligjor
Klasa e pozitës :	Profesional 1
Koeficienti/ paga :	G4-5.85
Nr. i kërkuar :	2
Data e njoftimit :	13/02/2024
Afati për aplikim :	14/02/2024 - 14/03/2024
Institucioni :	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
Departamenti :	Zyra Ligjore
Divizioni :	
Vendi Punës :	Prishtinë
Nr. i Referencës:	RN00011309
Kodi:	RPC 0006848



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Harton dhe merr pjesë aktive në hartimin e projekt-amendamenteve kushtetuese, projekt-marrëveshjeve ndërkombëtare, projekt-ligjeve dhe projekt-akteve nënligjore (akteve juridike);
2. Siguron dhe është përgjegjës për pajtueshmërinë e projekt akteve juridike që dorëzohen për shqyrtim dhe miratim në Qeveri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë;
3. Kryen revidimet ligjore dhe gjuhësore me qëllim që përmbajtja ligjore dhe kuptimi i projekt aktit juridik të jetë teknikisht i saktë;
4. Në bashkëpunim me njësitë përkatëse në kuadër të ZKM-së, njësitë apo personat përgjegjës për hartimin e projekt akteve juridike, shqyrtimin e koncept dokumenteve, vlerësimeve *ex post* të akteve juridike, përgatitjen e draft opinioneve të Qeverisë për nismat legjislative të Kuvendit, ndihmon në përputhshmërinë e akteve juridike të propozuara nga ZKM me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian – *Acquis* të BE-së, duke përfshirë përgatitjen e Deklaratës së Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP);
5. Sigurimi i përmbushjes së objektivave që dalin nga procesi i rregullimit më të mirë në zvogëlimin e barrës administrative gjatë procesit të hartimit të legjislacionit si dhe sigurimi i përfshirjes së propozimeve të tilla në Programin Legjislativ dhe Planin e Akteve Nënligjore;
6. Bashkërendimi dhe mbështetja e ministrive në zhvillimin e propozimeve për thjeshtimin e lejeve dhe licencave duke u bazuar në analiza, si dhe shqyrtimi i projekt akteve juridike që synojnë uljen e barrëve administrative duke thjeshtuar lejet dhe licencat;
7. Përcjellë mbarëvajtjen dhe ecurinë e procedurave për hartimin dhe procedimin e projekt akteve juridike për miratim në Qeveri;
8. Bashkërendon dhe ndërlihd punët sipas nevojës me zyrtarët e tjerë të Zyrës Ligjore dhe departamenteve ligjore të ministrive përgjegjëse apo institucioneve të tjera në fushën e ndarjes së punëve dhe detyrave në Zyrën Ligjore;
9. Ofron udhëzime juridike dhe shërbime këshilluese;
10. Ofron shqyrtimin e projekt akteve juridike që Qeveria i propozon Kuvendit për të siguruar përputhshmërinë me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, teknikat dhe standardet e hartimit të akteve juridike si dhe me instrumentet e së drejtës ndërkombëtare;
11. Ofron këshilla te veçanta juridike përkitazi me ministrinë përkatëse dhe ndërlihdet me departamentet përkatëse të ministrive;
12. Kryen detyra të tjera që ndërlihdhen me pozitën dhe mandatin e divizionit/Zyrës Ligjore sipas kërkesës së mbikëqyrësit

2. Kushtet e përgjithshme për pranimin në detyrë sipas nenit 9 të LZP-së:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- *Arsimimi i kërkuar:* Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Juridik .
- *Kualifikime të posaçme formale:*
- *Përvoja e punës e kërkuar:* Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë;

4. Njohurit , Aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën e hartimit, harmonizimit dhe zbatimit të legjislacionit;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të hartimit dhe harmonizimit të legjislacionit dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me këto detyra dhe përgjegjësi;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe në formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale gjatë hartimit dhe harmonizimit të legjislacionit;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështje teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- Njohuri në programet e Microsoft Office;
- Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme.
- Të jetë energjik dhe në gjendje të punojë me orar fleksibil dhe trysni kohe, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre

- Kopjen e diplomës universitare të kërkuar me konkurs me të dhëna nga institucionet arsimore, dëshminë e nostrifikimit për diplomat e fituar jashtë vendit .
- Dëshmi për përvojën e punës e lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet nëse referencat e përvojës, mbështeten me aktet përkatëse noteriale.
- Së paku njërën nga dëshmitë: dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.
- Kopjen e letërnjoftimit /Pasaportës e lëshuar nga Republika e Kosovës.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për zyrtaret publik dhe ata që kanë punuar në sektorin publik, ndërsa kandidatet jashtë sektorit publik- ofrojnë deklaratën me shkrim të vetë-nënshkruar) .



6. Data e daljes se rezultateve dhe vlerësimi paraprak

- Lista e kandidateve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë të shpallet me së largu deri më datën 29/03/2024 , në portalin e rekrutimit elektronik(<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shitesë

- nuk ka

8.Mënyra e vlerësimit të kandidatëve /aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9.Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet

- Përmes e-mailit dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10.Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidateve , fituesi do të shpallet përmes portalit per rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>) Të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shitesë:

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Kandidati përmes aplikimit deklaron dhe mbanë përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohet nga shpallja e procedurës së rekrutimit .

Bazuar në nenin 14 Rregullores (QRK)Nr.15/2023 për procedurën e pranimit në Shërbimin Civil, NJBN pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, bënë verifikimin përfundimtar para emërimit të plotësimit të kriterëve të aplikimit nga kandidati dhe kërkon kandidatit paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kriterëve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP.

